

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.02.2019 dhe të rikonfirmimit të datës 27.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kema Company" për aktivitetin: "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-8676-511 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Kema Company" e datës 25&27.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" dhe me Nr.616 18 8676 521, Nr. Brendshëm 616 18 133 511 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 20.02.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.02.2019*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Kema Comapny" me datë 25.02.2019 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në disa rrugë të fshati Hajvali dhe të fshatit Mramor në Prishtinë" me Nr.616 18 8676 511 Nr. Brendshëm 616 18 133 511".

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.02.2018 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi i vetëm i ankuesit në kërkesën e datës 25.02.2019 ka qenë se me datën 25.02.2019 nuk i është lejuar çasje në ofertën e tenderuesit të propozuar për dhënie të kontratës në platformën elektronike, por i janë dhënë vatëm materialet në formë fizike. Bazuar në këtë pretendim ju kemi sqaruar se mund të vini dhe të keni çasje në

ofertën nga platforma dhe keni konfirmuar pranimin tuaj lidhur me këtë. Bazuar në këtë ju keni ardhur me datën 26.02.2019 në orën 14:00 dhe zyrtari përgjegës ua ka paraqitur të gjitha dokumentet e dorëzuara në Platformën elektronike dhe ju keni dhënë vërejtje lidhur me vështirësitë për lexueshmërinë e disa prej tyre dhe për këtë i keni kërkuar në formë fizike për verifikim, si që e keni cekur edhe në procesverbalin e përpiluar me rastin e çasjes tuaj.

Pasiqë ju paraprakisht keni dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me pretendimin e vetëm se nuk u është lejuar çasja në platformë, pas realizimit të të njejtës me datën 26.02.2019, kemi kërkuar nga ju të deklaroheni se a mbeteni pranë pretendimeve tuaja dhe a keni pretendime të reja. Përgjegjja juaj ka qenë se do të vazhdoni pretendimet tuaja duke shtuar se disa dëshmi të makinerive të tenduesit të propozuar për dhëne të kontratës nuk janë fare të dukshme.

Lidhur me pretendimin tuaj të paraqitur në shkresën tuaj me datën 27.02.2019, ju sqaroj si vijon:

-Së pari ka një dallim të madh në mes të pretendimit tuaj se dëshmitë nuk janë fare të dukshme dhe konstatimit tuaj në procesverbal se disa nga ato janë vështirë të dukshme dhe se i keni marrë në formë fizike për verifikim;

-Së dyti ju nuk keni deklaruar asgjë lidhur me procesin e verifikimit të dëshmimeve që e keni cekur si qëllim tuajin në procesverbal; dhe

-Së treti ju sqaroj se edhe unë edhe anëtarët e komisionit i kanë trajtuar ato dëshmi në platformë si të lexueshme dhe sigurisht kushdo që do ti shoh do ti trajtoj si të tilla.

Bazuar në faktet e lartpërmenduar rrjedh se kërkesa juaj është e pa bazuar për arsyet si vijon:

-Pretendimi i parë nuk qëndron, pasi që çasjen në dokumentet nga platforma e keni realizuar me datën 27.02.2019;

-Pretendimi i dytë se dëshmitë në platformë nuk janë të dukshme nuk është i vertetë, pasi që është në kundërshtim edhe me konstatimin tuaj nga procesverbali; dhe

-Nuk keni sjellur asnjë konstatim apo provë lidhur me verifikimin e dëshmimeve që i keni marrë në formë fizike për këtë qëllim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në të gjitha konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit